

AKTUALITETI I DRAMËS ANTIKE NË DRAMËN E QOSES “BESELAM PSE MË FLIJOJNË”

Ermira YMERAJ, Klodeta DIBRA

ermira.ymeraj@unishk.edu.al, klodeta.dibra@unitir.edu.al

Hyrje

Fjala e shkruar në letërsi është parë nga shkrimtari si akt rezistence dhe mënyrë për të ndërtuar një diskurs të ri për të përballuar sfidat e realitetit politik dhe eksploruar flijimin e individit përballë padrejtësisë. Qosja në këtë arsytim është shkrimtari që në Kosovën e privuar nga liria, krijon një akt të ri¹ krijimi që nuk i nënshtrohet formave të vjetra apo modeleve të ngurta të shkrimit. Në vend të kësaj, ai përdor letërsinë si një instrument për të kundërshtuar strukturat e padrejta dhe për të krijuar një mundësi diskutimi mbi çështje ekzistenciale dhe sociale. Në këtë mënyrë, drama e tij bëhet përcjellëse e ideve, ku akti i shkrimit lidhet ngushtë me aktin e krijimit të një realiteti të ri, duke sfiduar strukturat ekzistuese.

Në këtë kontekst studiuesi Alimani thekson se: “*Drama antike bëhet drama aktuale gjithçka ndodh si dikur, ndoshta dhe më llahtarisht. Aktualiteti paraqitet si një drame antike*”². Ndaj akti i flijimit në dramë i shërben Qoses që të përdorë këtë rit tragjik përballë forcave të pamposhtura shoqërore, por gjithashtu të ngjallë dilemat bashkëkohore mbi fuqinë dhe ndikimin e individit për të ndryshuar rrjedhën e fatit. Qosja përmes këtij riti, arrin të shqyrtojë kontradiktat e brendshme të personazheve të realitetit të tij, krizën e tyre morale përballë pushtetit dhe padrejtësisë. Flijimi në këtë dramë merr një trajtë bashkëkohore, ndërsa konfliktet politike, sociale dhe psikologjike pasqyrojnë sfidat e realitetit modern, duke i dhënë veprës një dimension universal.

Metoda

Shqyrtimin e fatit të individit përballë rendit shoqëror do e zbërthejmë përmes përshkrimit, argumentimit, hulumtimit të të folurit të personazheve si dëshmi e natyrës njerëzore. Kadare thotë se: “Letërsia që në fillimet e saj, “*u lidh me aktin e flijimit*”. *Letërsia u mësua të kërkojë fli. Në një mënyrë ose në një tjetër ajo na kërkon ne. Në një mënyrë ose në një tjetër ne i paguajmë tributin*”³. Ky pohim na kujton se, si në antikitet, edhe në kohët moderne, simbolika e flijimit mbetet një forcë thelbësore për të interpretuar sfidat ekzistenciale dhe për të krijuar lidhje midis të kaluarës dhe të tashmes. Fjalët e personazheve hulumtohen në raport me: **idetë, temat, filozofinë, zbërthimin e tragjedisë dhe sakrificës**, si dhe ndikimin e tyre në ndërtimin e realitetit **politik dhe social**.

Fjala dhe kahet e saj. Fuqia e fjalës si mjet shprehës shfaqet ndërtuese, shkatërruese, përfshirëse, përjashtuese, si instrument komunikimi ose manipulimi. Duke folur mbi të kaluarën⁴ dhe të ardhmen, fjalët e Harunit përshkruajnë krizën e një bote të ndërtuar mbi

¹ **Mise en abime** (vendosur në humnerë). Shprehje e përdorur nga shkrimtari francez Andre Gide i cili e përshtati këtë koncept për kritikën moderne dhe letërsinë, duke e përdorur për të përshkruar një teknikë narrative, ku një histori përfshihet brenda një historie tjetër, shpesh duke krijuar një efekt reflektues ose rekursiv.

² Alimani, Fatmir. “*Katër K, Kafka, Kavabata, Kundeva, Kadare*”, Ese, Onufri 2005, f. 210.

³ Alimani, Fatmir. “*Katër K, Kafka, Kavabata, Kundeva, Kadare*”, Ese, Onufri 2005, f. 210.

⁴ Ferdinand de Saussure “*Cours de linguistique Générale*” 1916. **Aksi paradigmantik**. Përfaqëson repertorin e termave (kushteve), të lidhur nga kuptimi, por të ndryshëm për nga domethënia (significante), mes të cilëve autori operon selektimin e fjalëve më tërëqësive synimeve të formulimit të mesazhit të vet.

premtime të kota, duke nxjerrë në pah tensionin mes asaj që është thënë dhe asaj që është bërë, ndërsa të Molosit përcjellin pasiguri.

Tabelë 1. E folura e Harunit dhe Molosit

Kahja e fjalës si:	Haruni	Molosi	Domethëniet
Deshifrim i ideve dhe temave	“Pse nuk heqim dorë?” (Haruni, f. 182)	“Fatet sillen e pështillen...” (Molosi, f. 191)	Të dy pohimet paraqesin tensionin mes pasigurisë ⁵ dhe fatit të paracaktuar. Ideja e fatit të pashmangshëm ⁶ në antikitet shfaqet si mos shpresë.
Funksion filozofik	“Jemi ne të mallkuar apo janë themelet e vëna gabim?” ⁷ (Haruni, f. 179).	“E keqja ka shumë kopilë...” (Molosi, f. 192).	Dilema mes përgjegjësisë personale dhe realitetit të pashmangshëm. Absurdi i realitetit.
Zbërthim i tragjedisë dhe sakrificës	“Rrudhe gjuhën! Nuk jetoj me ëndrra si ti” (Haruni, f. 182).	“Dhimbja për gruan është dhimbje e madhe...” (Molosi, f. 286)	Tragjedia zbërthehet përmes vuajtjes personale, sakrificës femërore dhe humbjes. Njeriu refuzon t’u dorëzohet ëndrrave ⁸ .
Ndërtim i realitetit politik dhe social	“Sundimtari mbërrin me urdhra...” (Haruni, f. 183).	“Qëllimi: Që të dëshpërohen qytetarët...” (Molosi, f. 192).	Tensioni mes forcës politike dhe dëshpërimit social. Ndërtimi i urave dhe kështjellave nuk është në përputhje me simbolikën e hapjes dhe qëndresës po në lidhje me pushtetin dhe strukturat politike ⁹ .
Zhvillim i brendshëm personazhit	“Premtimi është si buka...” (Haruni, f. 184).	“Fjalimi i mirë, i dëlirë kur e mban ai që është i lirë...” (Molosi, f. 198).	Fjala si mjet reflektimi i brendshëm dhe zhvillim i identitetit të personazheve, te Qosja shfaqet me një dualizëm ¹⁰ të moralit dhe realitetit.

⁵ Për konceptin e qenies shih: Heidegger, M. “Qenia dhe koha”, Tragjedia si ndërgjegjësim për ekzistencën.

⁶ Për konceptin e “Po”-së shih: Heidegger, M. “Qenia dhe koha”. Të dy personazhet përballen me pyetje të pashmangshme mbi natyrën e ekzistencës dhe fatin.

⁷ Për absurditetin dhe sfidën e ekzistencës njerëzore shih: Camus, A. “Miti i Sizifit”, <https://www.docdroid.net/3LfQqhx/albert-camus-miti-i-sizifit-pdf>

⁸ Për tragjedinë si një reflektim i brendshëm i sakrificës në jetën njerëzore shih: Nietzsche, Friedrich. “Lindja e Tragjedisë”, Uegen, 2012.

⁹ Për mënyrat se si pushteti dhe kontrolli mbi shoqërinë formësojnë realitetin shih: Foucault, M “Disiplinë dhe ndëshkim”, Botimet Odeon 2010.

¹⁰ Për interpretimin e gjuhës në zhvillimin e vetëdijes dhe kuptimit shih: Gadamer, Hans-Georg. “E vërteta dhe metoda”, https://sq.swewe.net/word_show.htm/?457440_1&V%C3%ABrtet%C3%ABn_dhe_Metoda

Reflektim i tensionit dramatik	“Ëndërro. Në ëndrra i ndërton dëshirat...” (Haruni, f. 181).	“E shikuat? Viktima do të jetë grua...” (Molosi, f. 285).	Tensioni dramatik ¹¹ rritet përmes paralajmërimeve dhe ëndrrave të dështuara. Fjala paraqet tensionin mes shpresës dhe mosrealizimit.
Ndërmjetëse mes të shkuarës dhe të ardhmes	“Sundimtari mbërrin me urdhra ku të tjerët s’mbërrinë me sy e veshë...” (Haruni, f. 183).	“Kur nuk shihet e nesërmja, duhet të shihet e djeshmja...” (Molosi, f. 280).	Fjala ndërmjetëson të shkuarën dhe të ardhmen, duke lidhur realitetin politik dhe social të të dyve. Personazhet ndërtojnë vizione ¹² për të ardhmen përmes fjalës.
Simbolikë e fatit të personazheve	“Do t’i lodhe kotësia në qoftë se nuk ua vëmë qëllimin përpara...” (Haruni, f. 191).	“Le t’ia verbojë sytë shqiponja...” (Molosi, f. 269).	Fjala simbolizon jo vetëm fatin e personazheve, por edhe vizionin e një shoqërie të mundshme ¹³ . Simbolika e shqiponjës dhe e dragoit si figura tradicionale përfaqësojnë fuqinë dhe sakrificën.

Tabelë 2. Aktet e komunikimit të personazheve të tjera

Kumti i personazhit	Konteksti	Kumti social-psikologjik dhe politik
“Kush së pari kalon andej: ai që flet, apo ata që dëgjojnë?” (Haruni f. 177).	Fuqia e fjalës ¹⁴ së pushtetit mbi dëgjuesit.	Kjo fjali nxjerr në pah dilemën e marrëdhënieve midis pushtetit dhe qytetarëve. Njëkohësisht reflekton ndikimin e komunikimit, në perceptimin e kumteve.
“Me dyshim ia kemi filluar dhe me dyshim s’mund të vazhdojmë.” (Haruni f. 188).	Pasiguria ¹⁵ në ndërtimin e urës.	Personazhi bëhet mbartës i ndjenjës së pasigurisë dhe dyshimit që mbërthen njeriun në situatë të ndryshme. Është reflektim i psikologjisë së shoqërisë, ku pasiguria për të ardhmen bllokoi progresin, duke simbolizuar sfidat në ndërtimin e një sistemi të ri social e politik.
“Rrënues, dikush që mundet! Njeriu mundet, por mundësitë e tij kanë kufij.” (Haruni f. 193).	Dilemat ¹⁶ mbi fuqinë dhe limitet e njeriut.	Këtu reflektohet mbi kufijtë e fuqisë së individit, duke sjellë në pah kontrastin midis fuqisë njerëzore dhe fuqisë hyjnore, te Qosja, midis pushtetit dhe vartësve. Në aspektin social, kjo tregon kufizimet e individit në një shoqëri të kontrolluar nga forca me pushtet autokrat.

¹¹ Për rolin e katarsisit në dramë si një mënyrë për të krijuar pastrimin emocional përmes veprës shih: Aristotele “Poetika”, Shtëpia Botuese Çabej 2006.

¹² Për fjalën si manifestim i vetëdijes historike dhe shoqërore shih: Hegel, F. “*Phenomenology of Spirit*”, Cambridg Hegel Translations, 1807.

¹³ Për simbolizmin në gjuhë dhe kulturë shih: Cassirer, E. : “*Philosophy of Symbolic Forms*”, Yale University Press 1998

¹⁴ Për teorinë e vëmendjes dhe selektivitetit shih: Eagly & Chaiken, “*The Psychology of attitudes*” Harcourt Brace Jovanovich College Publishers 1993.

¹⁵ Për teorinë e pasigurisë shih: Miller P. H. “*Theories of developmental psychology*”, W H Freeman/Times Books/ Henry Holt & Co.1993.

¹⁶ Për teorinë e fuqisë dhe kufizimeve shih: Lukes S. “*A Radical View*”, 1974, <https://www.jstor.org/stable/3231142>

“Jam lodhur prej fjalimeve. Fol, fol, fol...” (Haruni f. 181).	Revolta ¹⁷ ndaj diskursit politik që të konsumon.	Lodhja nga përdorimi i fjalës si mjet propagandistik. Është një kritikë ndaj diskursit të zbrazët politik, që shpesh herë nuk arrin të sjellë ndryshim të vërtetë, duke sjellë veç një ndjenjë zhgënjimi dhe dëshpërimi social.
“Kur populli dëshpërohet e keqja nuk ka masë, as skaj” (Monuni f. 183).	Pasiguria ¹⁸ mbi stabilitetin social.	Frika se kur shpresa humbet, shoqëria zhytet në kaos. Ky mesazh është një paralajmërim për pasojat e dëshpërimit masiv, ku mungesa e drejtimit dhe shpresës çon në destabilitet politik.
“Premtimi është si buka: e ke, rri qetë; s’e ke, e lyp!” (Haruni f. 184).	Vlera premtimeve ¹⁹ politike.	Premtimi përfaqëson një kumt thelbësor për stabilitetin e shoqërisë, ashtu si buka për jetesën. Kumti është që premtimet e parealizuara çojnë në krizë dhe paqëndrueshmëri, ndërsa realizimi i tyre siguron qetësinë sociale.
“Do t’i lodhe kotësia në qoftë se nuk ua vëmë qëllimin përpara.” (Haruni f. 197).	Qëllimet sundimit ²⁰ .	Rëndësinë e qëllimit dhe drejtimit të qartë në politikë. Pa një qëllim të përcaktuar, shoqëria humbet motivimin dhe energjinë për të vepruar.
“Fjali e dëlirë kur e mban ai që është i lirë zëvendëson edhe parashikimin e errët.” (Monuni f. 198).	Fuqia ²¹ e lirisë së fjalës.	Rëndësia e fjalës së singertë të individit i lirë, tregon se fjala e lirë ka fuqinë të ngrejë shpresën dhe të zëvendësojë frikën, duke ndërtuar një frymë pozitive në një realitet të zymtë social.
“Kur të kryhet ura, më lehtë do të durojnë tepricën e vet.” (Haruni f. 196).	Ura si ndërmjetëse ²² .	Ndërtimi i urës këtu simbolizon një zgjidhje të ardhshme që lehtëson barrën e shoqërisë. Në aspektin social, ura lexohet si metaforë e bashkëpunimit dhe stabilitetit politik, që mbështetet mbi një bazë të përbashkët.
“Mund t’i trillosh, siç bëjnë sundimtarët”. (Monuni f. 183).	Manipulimi i fjalës nga pushteti.	Sundimtarët e përdorin fjalën për të manipuluar realitetin, duke trilluar qëllimisht për të mbajtur pushtetin dhe për të kontrolluar masat. Fjala si mjet manipulimi psikologjik dhe kontrolli politik.

Fjalimet e Molosit dhe Harunit veprojnë si mjete për të zbuluar dhe dekoduar tensionet ndërmjet të vërtetës filozofike dhe realitetit politik. Fjalët e personazheve mbartin kështu një peshë të madhe simbolike, që shprehet në referencat e autorit ndaj shqiptonjës dhe dragoit, duke nënkuptuar kështu fuqinë e fjalës si përfaqësuese e fatit të individit dhe realitetit të shoqërisë.

¹⁷ Për teorinë e diskursit dhe përdorimit politik të fjalës shih: Foucault, M. “*The Archaeology of Knowledge and the Discourse on language*”, Pantheons book New York 1972

¹⁸ Për teorinë e stabilitetit social shih: Parsons, T. “*The Social System*” Routledge, 1951.

¹⁹ Për teorinë e premtimeve politike shih: Buchanan & Tullock, “*The Calculus of Consent*”, The University of Michigan Press, 1962.

²⁰ Për teorinë e motivimit shih: Maslow, A.H. “*A Theory of human motivation*”, York University Press, 1943).

²¹ Shih: Mill J: S., “*On Liberty*” John Parker and son, West Strand 1859.

²² Shih: Aschauer, D “*Infrastructure and Economic Growth*”, 1989, <https://www.aeaweb.org/articles?id=10.1257/jep.6.4.189>.

Tabela 3. Aktet e komunikimit të personazheve të tjera

Kumti i personazhit	Funksioni filozofik i kumteve heroit	Zbërthimi i sakrificës dhe realitetit	Fjala zhvillim i brendshëm i personazhit	Reflektimi i tensionit dramatik dhe simbolika
Hana: “Është filluar me fjalë të mëdha e do të vazhdojë me kërcënime.” f. 210.	Zbërthen ndikimin e frikës si mjet për të ruajtur pushtetin ²³ dhe kontrollin social.	Kërcënimet janë një formë sakrifice e ndjenjës së lirisë.	Fjala e saj shërben për të ruajtur ekuilibrin.	Tensioni mes fjalës dhe dhunës, kriza morale dhe ekzistenciale që lidhet me sakrificën.
Beselam: “Si do të dijë njeriu kush është në qoftë se ndonjë vështirësi si del përpara...” f. 211.	Reflekton filozofinë e vuajtjes si një formë e ndërtimit të identitetit ²⁴ dhe karakterit njerëzor.	Sakrifica është një mënyrë për të testuar kufijtë njerëzorë, duke krijuar një realitet më të thellë dhe të sinqertë për veten.	Fjala zbulon konflikte të brendshme, duke shndërruar dialogun në një mjet për të arritur një vetëdije më të lartë.	Një përplasje e fortë mes dëshirës për vetëdije dhe dhimbjes që sjell sakrifica.
Hana: “Mos fol me të madhe! Mund të dëgjojë kush s’duhet...” f. 211.	Filozofia e frikës dhe censurës në mbrojtjen e paqes sociale ²⁵ . Heshtja si strategji mbrojtëse.	Sakrifica e së vërtetës për hir të paqes dhe stabilitetit të jashtëm.	Zhvillimi i brendshëm i personazhit karakterizohet nga lufta mes frikës dhe dëshirës.	Tensioni dramatik rritet kur frika dhe censura përdoren si mjete të ruajtjes së kontrollit.
Beselam: “Ku dhemb më shumë? Ku dhemb më pak?” f. 290.	Kjo pyetje filozofike i referohet relativitetit të vuajtjes dhe vështirësisë për të matur dhimbjen njerëzore ²⁶ .	Sakrifica shihet si e pashmangshme në zgjimin e mëshirës dhe aktivizimit të ndjeshmërisë kolektive.	Fjala zbërthen konflikte ekzistenciale dhe kthehet në një mjet që i qaset vetes dhe botës.	Kulmi dramatik i sakrificës që paraqitet si një domosdoshmëri sociale dhe morale.

²³ Shih: Qose, R. “Beselam pse më flijojnë” në “Mite të zhveshura”, Prishtinë 1978.

²⁴ Shih: Foucault, M. “Discipline and Punish” Print Book Englisj, 1977.

²⁵ Shih: Arendt, H. “The Human Condition” University of Chicago Press, 1958.

²⁶ Shih: Nietzsche, F. “The Birth of Tragedy” (1872), (English Translation 2003 by Penguin Classics).

Laidi: “ <i>Kush duhet të bëjë sakrificë?</i> ” f. 205.	Përcakton përgjegjësinë e pushtetit ²⁷ .	Sakrifica si simbol i pushtetit absolut dhe domosdoshmërisë për të ruajtur rendin.	Përgjegjësitë morale në strukturën e pushtetit	Dilemat e drejtësisë sociale.
Ixhili: “ <i>Dyshimi lehtë bëhet bindje. E vërteta nuk i takon njeriut.</i> ” f. 213.	Eksploron natyrën e dyshimit ²⁸ si një mjet filozofik për të arritur të vërtetën.	Dyshimi është shtytje e brendshme për të arritur të vërtetën.	Fjala zbërthen dilemat e dyshimit dhe sigurisë, duke çuar në zhvillimin e mendimit të brendshëm.	Kontrasti mes dyshimit dhe bindjes, duke reflektuar tensionin dramatik të kërkimit të të vërtetës.
Iblisi: “ <i>Ti dëgjon vetëm kur flitet, e unë dëgjoj edhe kur pëshpëritet.</i> ” f. 273.	Filozofia e fshehtësisë. Pushteti ²⁹ që vjen nga njohja e të fshehtës të botës së brendshme.	Iblisi simbolizon sakrificën e dritës për njohjen e errësirës.	Hyrja në dimensionin e fshehtësisë.	Tensioni mes fshehtësisë dhe dijes publike, thellon kontradiktën mes moralit dhe njohurisë.

Tabelë 4. Narrativa e Haranit dhe arketipi i të folurës

Kumti i personazhit	Funksioni filozofik i kumteve heroit	Zbërthim i sakrificës dhe realitetit	Fjala si zhvillim i brendshëm i personazhit	Reflektim i tensionit dramatik dhe simbolika
“ <i>Kjo është një çështje që kërkon zgjidhje të drejtë dhe të mençur...</i> ” f. 177.	Ndërgjegjësimi për zgjidhjen e drejtë.	Sakrifica si domosdoshmëri për drejtësi.	Drejtësia dhe mençuria në vendimarrje.	Drejtëpeshim.
“ <i>Me dyshim ia kemi filluar dhe me dyshim s’mund të vazhdojmë. Ku ndërtohen kalatë nuk mund të ndërtohen urat.</i> ” f. 188.	Reflekton natyrën e dyshimit dhe kufijtë midis ndërtimit dhe shkatërrimit si parime filozofike.	Sugjeron tragjedinë e përplasjes midis dy idealeve – kalatë si simbol i mbrojtjes dhe urat si simbol i komunikimit, duke shfaqur sakrificën e	Kritikon politikat që fokusohen vetëm në ndërtimin e mureve mbrojtëse dhe harrojnë ndërtimin e lidhjeve të	Fjala e Haranit ndërmjetëson tensionin mes ndërtimit të kështjellave dhe urave, si dy realitete të ndryshme. Ndarja mes mbrojtjes (kalatë) dhe

²⁷ Shih: Derrida, J. “*The Gift of Death*” (1995), University of Chicago Press.

²⁸ Shih: Descartes, R. “*Meditations on First Philosophy*” (1641), Cambridge University Press.

²⁹ Shih: Bataille, G. “*Erotism: Death and Sensuality*” (1957), City Light Books, San Francisco.

		lidhjes njerëzore.	ndërsjella në shoqëri.	lidhjes (urat), si dhe sfidat e politikës në ndërtimin e një shoqërie të balancuar.
“Rrënues, dikush që mundet! Njeriu mundet, por mundësitë e tij kanë kufij, vetëm i madhi s’njeh kufij.” f. 193.	Reflekton kufizimet e njeriut dhe forcën e pushtetit absolut, duke vënë theksin në filozofinë e pushtetit të pakufizuar.	Jep tragjedinë e njeriut që kërkon pushtet përtej kapaciteteve të tij, duke shkaktuar sakrifica të panevojshme.	Reflekton realitetin të pushtetit.	Reflekton tensionin mes ambicieve të individiut dhe fuqisë së sundimtarit në pushtetin e tij pakufi. Ndërmjetëson marrëdhënien midis njeriut dhe pushtetit absolut. Fuqia e pakufizuar e sundimtarit dhe kufizimet e njeriut të zakonshëm.
“Njeriu është një hije, një hijet që të bëhet, e si hijet që lëviz...” f. 193.	Kufizimet e njeriut dhe pushteti absolut.	Sakrifica për të ruajtur pushtetin dhe rendin.	Reflekton pushtet.	Kriza sociale dhe politike, barrë mbi popullin.
“Të përgjigjesh! Po në qoftë se nuk e di rëndësinë e pyetjes, as të përgjigjes, atëherë detyrohem të ta mësojmë.” f. 244.	Reflekton mbi rëndësinë e dijes dhe detyrën për të zbuluar të vërtetën përmes dialogut filozofik.	Sugjeron sakrificën e individiut që është i detyruar të përballet me dhunën e pushtetit.	Imponimi i autoritetit.	Tensioni dramatik rritet kur individi është nën trysninë e pushtetit. Dhuna dhe manipulimi përmes mungesës së dijes.
“Kur më pyetën për ndihmë, ndihmova me shpresë...” f. 244.	Përgjegjësia në kontekstin e sakrificës.	Sakrifica si detyrë ndaj shoqërisë.	Humanizëm.	Përgjegjësia dhe humanizmi si elemente të moralit.
“S’e di rrezikun e urës s’e di dobinë e kështjellës, mohon rëndësinë e lutjes! Me çfarë të drejte! Në emrin e kujt bën	E drejta për të vepruar.	Tragjedia e mohimit të rendit të vendosur.	Legjitimiteti i veprimeve.	Mosmarrëveshjet rrisin tensionin dramatik. Konflikti dhe mungesa e legjitimitetit të autoritetit moral.

ndërtimin e urës?” f. 247.				
“Është një e vërtetë e mrekullueshme, por që nuk është e lehtë të përballohet...” f. 247.	Filozofia e së vërtetës dhe sfida për ta përballuar.	Sakrifica si përpjekje për të arritur të vërtetën.	Sakrificë.	Ndërthurja e së vërtetës dhe sfidës.

Tabelë 4. Narrativa e Monunit dhe arketipi i të folurës

Kumti i personazhit	Funksioni filozofik i kumteve të heroit	Fjala si zhvillim i brendshëm i personazhit	Reflektim i tensionit dramatik dhe simbolika
“Lartmadhëri, kur flitet prej së larti më shumë dëgjohet.” f. 177.	Parashtron idenë se fuqia e fjalës vjen nga hierarkia. Sugjeron lidhjen midis pushtetit dhe përgjegjësisë, duke e vendosur fjalën në qendër të veprimit.	Heroi zhvillohet si personazh që kupton kompleksitetin e pushtetit dhe ndikimit të fjalëve.	Fjala e pushtetit, kontrolli dhe ndikimi mbi shoqërinë.
“Nuk do t’i nxërë qyteti nesër, do t’u zihet fryma, do të bëhen barra e vetvetes dhe barra e sundimtarit të tyre.” f. 196.	Paralajmëron krizën sociale dhe politike që vjen nga teprimi i premtimeve dhe mosrealizimi i tyre.	Zhgënjim i përgjithshëm.	Kriza politike dhe shoqërore buron nga pabarazia dhe sundimi i pamëshirshëm.
“Sundimtari mbërrin me urdhra ku të tjerët s’mbërrijnë me sy e veshë.” f. 183.	Centralizimi i autoritarizmit dhe pushtetit. Autoriteti absolut i sundimtarit.	Distanca mes pushtetit dhe njerëzve, reflekton mbi rolin e saj në sistem.	Fjala e sundimtarit vepron si vegël kontrolli dhe manipulimi. Izolimi i masave nga pushteti dhe centralizimi i forcës në duart e sundimtarit.
“Nëse ka ndonjë ndihmë, ajo duhet të jetë e ndershme dhe e mençur...” f. 183.	Sakrifica si pjesë e drejtësisë dhe ndihmës.	Ndihma si një akt i drejtë dhe i mençur	Ndihma dhe drejtësia në procesin e vendimmarrjes
“Mos ndërro mendjen, foli siç ke premtuar. Fjala jote zgjon bimët dhe shton të lashtat, sjell	Reflekton fuqinë krijuese të fjalës dhe të mbajtjes së premtimeve si bazë e ndërtimit shoqëror.	Lidhja e drejtpërdrejtë mes fjalëve dhe veprave, transformon rolin e tij nga një vëzhgues në një aktor aktiv.	Fjala ndërmjetëson ndërtimin e së ardhmes dhe të shpresave të popullit. Rilindja përmes fuqisë së fjalës së premtuar.

<i>dritën dhe i këndell foshnjat.” f. 197.</i>			
<i>“Pse rendi dhe nevoja nuk janë gjithnjë në përputhje.” f. 243.</i>	Harmonia mes rendit të krijuar dhe nevojave të vërteta të shoqërisë.	Zhvillimi i brendshëm përballë një krize morale dhe shoqërore.	Ndërtimi dramatik ndodh përmes ekspozimit të disharmonisë midis autoritetit dhe realitetit. Krisja e rendit të imponuar dhe fillimi i ndryshimit të pashmangshëm.

Tabelë 5. Narrativa e Molosit dhe arketipi i të folurës

Kumti i personazhit	Funksioni filozofik i kumteve të heroit	Fjala si zhvillim i brendshëm i personazhit	Reflektim i tensionit dramatik dhe simbolika
<i>“Nuk di gjë se ka rë. Të dish si do të jetë sot është shumë më e vështirë se të dish si do të jetë mot. Fatet sillen e pështillen dhe diku larg, ku s’ arrin syri lidhen.” f. 191.</i>	Reflekton mbi natyrën e pasigurisë dhe kompleksitetin e fatit si koncept filozofik.	Molosi pranon ndikimin e fatit si shkaktare e pasigurisë.	Tensioni dramatik pasqyrohet përmes mungesës së dijes dhe pamundësisë për të parashikuar të ardhmen. Fatin i fshehur dhe i ndërlikuar, si një fuqi që vepron jashtë kontrollit të njeriut.
<i>“Shkaku: Që të mos ndërtohet ura, se te ne nuk ka burra...” f. 192.</i>	Pamjaftueshmëria e dijes për t’u përballë me ndryshimet.	Vetëdija e heroit ngrihet mbi kufizimet e komunitetit dhe mungesës së fuqisë për të ndryshuar.	Një shoqëri në krizë.
<i>“Fjalimi i mirë, i dëlirë kur e mban ai që është i lirë e zëvendëson edhe parashikimin e errët, dhe shton shpresën më të zbetë.” f. 198.</i>	Fuqia e fjalës së lirë në transformimin e realitetit dhe ruajtjen e shpresës.	Heroi përparon duke kuptuar rëndësinë e lirisë së fjalës si mjet për ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë.	Tensioni dramatik zbutet kur fjala e lirë zëvendëson frikën dhe dëshpërimin. Fuqia e fjalës së lirë nxit shpresë në kohë të vështira.
<i>“Anët janë anë, urat janë ura, kështjellat janë kështjella, dhe ndryshojnë, siç ndryshojnë dhe njerëzit që i diktojnë.” f. 241.</i>	Relativizmi filozofik dhe ndryshueshmëria e gjërave, përfshin strukturat dhe individët që i ndërtojnë.	Zhvillon një kuptim më të thellë të relativitetit.	Tensioni dramatik pasqyrohet në ndryshimet e vazhdueshme që krijojnë pasiguri dhe paqëndrueshmëri.
<i>“Peshën e fatkeqësisë s’e kapin okët, në mos pushofshin</i>	Pesha e fatkeqësisë dhe efektet	Vetëdija e thellë mbi peshën e rrënimëve.	Tensioni dramatik rritet përmes kërcënimit dhe

<i>rrënimet do të shkojnë kokat.” f. 260.</i>	shkatërruese që ajo ka në shoqëri.		rezikut që shkatërrimet sjellin në shoqëri.
<i>“Kur nuk shihet e nesërmja, duhet të shihet e djeshmja, se të dyja takohen në të tretën dhe ashtu tregojnë të vërtetën.” f. 280.</i>	Koncepti filozofik i kohës dhe lidhjes mes së kaluarës, së tashmes dhe së ardhmes.	Vetëdija e njohjes së të kaluarës për të kuptuar të tashmen dhe të ardhmen.	Tensioni dramatik rritet përmes paqartësisë të së ardhmes dhe nevojës për të gjetur përgjigjet të kaluara.

Përqasja e fjalës në ndërtimin e tragjedisë bashkëkohore

Në narrativën e heronjve, sipas Judith Butler fjala ka fuqi për të krijuar realitet dhe identitete përmes shfaqjes së tyre. Fjala e folur te Qosja nuk është thjesht një mjet komunikimi, po dhe akt përmbushjeje që ndërton dhe sfidon strukturat ekzistuese të pushtetit dhe identitetit. Dialogu në dramë manifeston tensionet dhe konfliktet mes individit dhe shoqërisë, duke reflektuar përpjekjet e personazheve për të manipuluar dhe ndryshuar status quo-në. Ndërsa sipas Friedrich Nietzsche, fjala ka një ndikim të thellë në ndërtimin e kuptimit të realitetit. Në “Beselam pse më flijojnë”, fjala e shkruar e ndihmon lexuesin të meditojë mbi ndërlikimet e fatit dhe drejtësisë, e ndihmon në formulimin e pyetjeve ekzistenciale që janë thelbësore për temën e flijimit dhe konfliktet. Sipas Aristotelit, tensioni dramatik është një element kyç në tragjedi, që ndihmon në zhvillimin e intrigës dhe karaktereve. Në dramën e Qoses, fjala e shkruar dhe e folur bashkëpunojnë për të ndërtuar një tension dramatik që pasqyron krizat morale dhe ekzistenciale të kohës moderne.

Në dramën e Qoses, fjala e shkruar përfaqëson një formë të përhershme të interpretimit të realitetit, ku mendimi dhe mesazhet marrin një dimension më të thellë në lexim dhe analizë. Teksti dramatik i Qoses përbëhet nga një strukturë e hollësishme që kërkon deshifrimin e ideve dhe temave që lidhen me flijimin, drejtësinë, dhe kontradiktat e brendshme të individit dhe shoqërisë. Fjala e shkruar në këtë dramë ka funksion filozofik të qartë. Në planin estetik nxit individin të meditojë mbi ekzistencën e tij. Dialogu i ndërlikuar nxit një analizë të hollësishme, ku personazhet zbërthejnë idetë themelore të tragjedisë dhe sakrificës. Fjala kërkon deshifrim të lexuesit si akt krijim që ndikon më shumë përmes mendimit sesa përmes veprimt.

Nisur nga simbolika e flijimit, në “Beselam pse më flijojnë”, flijimi nuk është thjesht një akt sakrifice, por një simbol i përjetshëm i luftës së individit me kufijtë e lirisë dhe pushtetit. Në këtë kontekst, flijimi në dramë përfaqëson sfidat ekzistenciale me të cilat përballlet individi në kohën moderne. Në raport me realitetin social politik, fjala e shkruar është mjeti me të cilin lexuesi ndjek dhe zbulon pasqyrën e konflikteve dhe tensioneve si pjesë e realitetit politik dhe social, duke krijuar një hapësirë për reflektim dhe analizë të thellë. Te Rexhep Qosja fjala ka një përdorim të sofistikuar dhe shumëdimensional, ajo:

Ofron dimension filozofik dhe reflektues;

thekson aspektet e krimeve morale dhe ekzistenciale të pushtetit dhe shoqërisë;

krijon tensione të menjëhershme dhe dinamike që pasqyrojnë konflikte dhe realitete sociale; mbartëse e krizave të kohës modern;

ndihmon në ndërtimin e tragjedisë bashkëkohore;

krijon një pasqyrë të fuqishme të dilemave dhe tensioneve me të cilën përballen individët dhe shoqëritë.

Në dramën “Beselam pse më flijojnë”, fjalët veprojnë si çelësa për të deshifruar filozofinë dhe estetikën e veprës. Qosja eksploron krizat morale dhe ekzistenciale të një shoqërie të ndarë nga konfliktet politike dhe sociale. Flijimi në këtë kontekst merr një trajtë bashkëkohore, ku

personazhet jo vetëm që sakrifikohen për idetë e tyre, por gjithashtu ballafaqohen me një rend shoqëror që ndëshkon ata që kërkojnë të ndryshojnë fatin. Flijimi bëhet një akt përfaqësues i përjetshëm i luftës së individit me forcat që e rrethojnë.